

Analizë mbi Strategjinë për Veprimtari Kërkimore-Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013-2016 dhe ndikimin e saj në punën e instituteve kërkimore në Universitetin e Prishtinës

CPC, 27 qershor 2014

RRPP Dialogu për politika – Analizë 1/2014

Hyrje

Synimi i kësaj analize është të vlerësojë zbatimin e „Strategjisë për Veprimtari Kërkimore-Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013-2016” (Strategjia për Hulumtim) dhe ndikimin e saj në punën e Universitetit të Prishtinës (UP). Si njësi koordinuese lokale e dialogut të filluar në mes të politikëbërësve dhe hulumtuesve në Kosovë në kuadër të Dialogut për Politika të Programit për Promovim të Hulumtimeve Rajonale në Ballkanin Perëndimor (RRPP), CPC ka themeluar një grup avokues të përbërë nga profesorë të UP-së, zyrtarë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe përfaqësues të organizatave think-tank të orientuar nga fusha e edukimit. Të gjeturat nga kjo analizë do të shërbejnë si një mjet për të avokuar për implementim më gjithëpërfshirës të komponentave përkatëse të Strategjisë për Hulumtim. E gjetura kryesore e kësaj analize është se UP është duke implementuar vetëm në mënyrë të pjesëshme Strategjinë për Hulumtim. Rekomandimet specifike për UP janë ndarë në tre nëngrupe: (1) etika dhe kualiteti i hulumtimit, (2) reforma të brendshme, dhe (3) bashkëpunimi i jashtëm. Këto rekomandime janë nxjerrë nga tryeza „Strategjia dhe ndikimi i saj në punën e instituteve kërkimore të UP-së”, mbajtur më 27 qershor 2014 në ambientet e Rektoratit të UP-së.

Sfondi

Kapacitetet për hulumtim dhe gatishmëria për të përkrahur aktivitetet kërkimore në UP vazhdojnë të ngelin në nivel të ulët. Duke qenë se UP-ja mbetet një institucion kryesisht mësimdhënës, aktivitetet kërkimore janë të rralla dhe të pakoordinuara. Kjo gjendje mbizotëruese u përkeqësua edhe më tej nga menaxhmenti i kaluar i UP-së, ndodhi që edhe vetë Rektori i mëparshëm në vitin 2013 abuzoi me pozitën e tij duke botuar punime të dyshimta në revista mashtruese jashtë vendit me synimin për t’u promovuar në pozitë më të lartë akademike. Pasi që kjo doli në shesh¹, rasti rezultoi me protesta masive dhe si rezultat i presionit të studentëve, profesorëve, publikut dhe mediave, Rektori u detyrua të jepte dorëheqjen në shkurt të vitit 2014.

¹ Për të ilustruar cilësinë e ulët dhe standardet e revistës në të cilën ish-rektori kishte botuar punimet, një person anonim duke përdorur një emër imagjinar (Filan Fisteku), pasi kishte paguar tarifën e nevojshme, arriti të publikojë në të njëjtën revistë mashtruese ad litteram pjesë të tëra të „Manifestit Komunist” nga Karl Marksi. Edhe pse një dokument i njohur gjerësisht, punimi „i propozuar” kërkimor ishte pranuar dhe botuar nga po e njëjta revistë.

Ky rast ilustron nivelin dhe kualitetin e shumë veprimtarive kinse shkencore në UP dhe në Kosovë në përgjithësi. Sigurisht, rastet e tilla nuk janë të izoluara marrë për bazë faktin se një numër i konsideruar i stafit akademik, përfshirë këtu zyrtarë të lartë në institucionet publike të Kosovës, janë ngritur në karrierë duke u bazuar në kredenciale të dyshimta akademike.

Problemet lidhur me aktivitetet kërkimore në Kosovë janë sistematike. Investimi në shkencë dhe hulumtime shkencore nuk ka qenë asnjëherë prioritet strategjik dhe nuk ka fituar vëmendje të mjaftueshme nga politikëbërësit në Kosovë. Për më tepër, marrëdhëniet në mes të kërkimit, në njërin anë, dhe ekonomisë dhe shoqërisë në anën tjetër, mbeten plotësisht të pakoordinuara. Që Kosova të bëhet një „Shtet i dijes”, siç thuhet në slogonin e MASHT, kërkimet shkencore në përgjithësi dhe përgatitja e studiuesve të rinj për të bërë hulumtim bazuar në metoda bashkëkohore, duhet të bëhet vërtetë prioritet kombëtar. Kjo kërkon jo vetëm investime, por edhe etikë akademike dhe transparencë të plotë.

Meqenëse kjo analizë shkruhet në kohën kur UP udhëhiqet nga një trup menaxhues me mandat të përkohshëm, do të ishte problematike të bëhet një vlerësim konsistent dhe shumëdimensional i hulumtimeve shkencore në UP për gjysmën e parë të vitit 2014. Menaxhmenti i përkohshëm ka ndërmarrë disa hapa në përpjekje të ngritjes së transparencës, rikthimit të besimit në etikën akademike dhe përmirësimin e imazhit të UP-së në përgjithësi. Sido që të jetë, masa të tilla si publikimi i CV-ve të stafit akademik në uebfaqen zyrtare të UP-së nuk janë të mjaftueshme. Një rregullore për avansim në grada shkencore në UP është aprovuar, por është e pasigurtë nëse kjo rregullore mund të adresojë problemet aktuale meqenëse përjashton heqjen e përgjegjësisë themelore akademike për të dhënë vlerësim profesional mbi kontributet shkencore dhe profesionale. Megjithatë, një çështje e rëndësishme siç është korrupsioni akademik e që ka ndikim të drejtpërdrejtë negativ në sistemin e hulumtimeve mbetet i patrajtuar.

CPC në analizën e realizuar në prill 2013, [„Gjendja e kërkimeve në shkencat shoqërore në Universitetin e Prishtinës”](#), ka bërë një përshkrim të gjendjes së kërkimeve shkencore në UP.² Për të matur progresin dhe hapat e ndërmarrë për të avancuar kërkimet shkencore në UP, këtu do të analizohet se cilët hapa janë ndërmarrë për të implementuar Strategjinë për Hulumtim, si një dokument që synon të hartëzojë rrugën drejt avancimit të kërkimeve shkencore në UP.

Strategjia për Hulumtim

Strategjia për Hulumtim fokusohet në katër fusha, të cilat po ashtu korrespondojnë edhe me Programin Kombëtar të Shkencës. Këto fusha përfshijnë: burimet njerëzore, infrastruktura për kërkime shkencore, bashkëpunimi ndërkombëtar, dhe lidhja me ekonominë dhe shoqërinë.

² Në prill të vitit 2013, CPC ka krijuar një grup punues të përbërë nga përfaqësues të MASHT, Rektorati i UP-së, profesorë të Departamentit të Shkencës Politike, Departamentit të Sociologjisë, Fakultetit Juridik, dhe përfaqësues të shoqërisë civile, me synimin për të kontribuar dhe avokuar për përmirësimin e kapaciteteve hulumtuese. Shih p.sh. Gjendja e Kërkimeve në Shkencat Shoqërore në Universitetin e Prishtinës. CPC, Prishtinë, prill 2013. http://cpc-ks.org/repository/docs/Briefing_paper_The_State_of_Research_in_Social_Sciences_at_the_University_of_Prishti_na_%28Albanian%29_336256.pdf (qasur më 8 korrik 2014).

1. **Burimet njerëzore** përfshijnë 6 prioritete, në mes tjerash, zhvillimin e programeve të doktoratave, ofrimin e fondeve për qëndrime afatshkurtëra jashtë vendit për stafin e UP-së, stimulimin e personelit për punë kërkimore, përfshirjen e kapaciteteve të diasporës në veprimtari kërkimore dhe rregullimin e veprimtarisë kërkimore të stafit të UP-së përmes kontratave të punës.
2. **Infrastruktura** përfshin 5 prioritete, në mes tjerash, krijimin e një baze të të dhënave për kapacitetet infrastrukturore të UP-së, krijimin e laboratorëve, themelimin e instituteve dhe ofrimin e qasjes në biblioteka elektronike.
3. **Ndërkombëtarizimi** përfshin 4 prioritete, në mes tjerash, partneritetet strategjike në mes të UP-së dhe institucioneve ndërkombëtare, asistencën teknike për hartimin e projekteve, ofrimin e programeve profesionale në përputhje me kërkesat e tregut, dhe bashkëfinancimin e UP-së në projekte me karakter ndërkombëtar.
4. **Shkenca dhe ekonomia** përfshin 4 prioritete, në mes tjerash, krijimin e një baze të të dhënave për projektet bashkëpunuese të UP-së me sektoret publik dhe privat, ofrimi i programeve profesionale, përfshirja e bizneseve në hartimin e programeve akademike të UP-së dhe angazhimi i përbashkët i UP-së dhe sektorit privat në kërkime të përbashkëta shkencore.³

Në tabelën e mëposhtme ilustron buxheti i ndarë për secilën prej fushave që mbulon Strategjia për Hulumtim. Siç është cekur në Strategjinë për Hulumtim, buxheti i planifikuar është 1.5% deri 3% nga buxheti total vjetor i UP-së. Qysh në vitin 2013, palët e përfshira në Dialogun për Politikën të RRPP koordinuar nga CPC, kanë ngritur çështjen se ndryshimi në mes të 1.5% deri në 3% është i madh dhe i padefinuar. Si pasojë, kjo ka implikime të drejtpërdrejta financiare kur kjo përkthehet në buxhetin total që duhet të dedikohet për implementim të kësaj strategjie.⁴

³ Strategjia për Veprimtari Kërkimore Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013– 2016, f. 8. Shih <http://www.uni-pr.edu/getattachment/4fc95f03-b53f-4e7c-a2a0-c0056b9c43e4/Strategjia-per-veprimtari-kerkimore-shkencore-arti.aspx> (qasur më 2 korrik 2014). Ky dokument është në përputhje me fushat e Programit Kombëtar të Shkencës i Republikës së Kosovës, shih Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës 2010-2015, <http://www.uni-pr.edu/getattachment/21dfd45e-cd3e-47da-ad78-a2fe060ec1e9/Programi-Kombetar-i-Shkences-i-Republikes-se-Kosov.aspx> (qasur më 2 korrik 2014).

⁴ Shih Gjendja e Kërkimeve në Shkencat Shoqërore në Universitetin e Prishtinës. CPC, Prishtinë, prill 2013. http://cpc-ks.org/repository/docs/Briefing_paper_The_State_of_Research_in_Social_Sciences_at_the_University_of_Prishti_na_%28Albanian%29_336256.pdf (qasur më 8 korrik 2014).

Tabela: Buxheti i planifikuar për zbatimin e „Strategjisë për Veprimtari Kërkimore-Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013-2016”⁵

Fusha	Buxheti				
	2012/13	2013/14	2014/15	2015/16	Gjithsej
Burimet njerëzore	€140,000	€140,000	€140,000	€140,000	€560,000
Infrastruktura	€10,000	€113,000	€250,000	€250,000	€623,000
Bashkëpunimi ndërkombëtar	€55,000	€185,000	€185,000	€185,000	€560,000
Lidhja me ekonominë dhe me shoqërinë	€0	€ 5,000	€0	€0	€ 5,000
Menaxhimi	€17,150	€21,200	€21,200	€21,200	€80,750
Total	€222,150	€464,200	€596,200	€596,200	€ 1,828,750

Megjithatë, ky buxhet prej 1.5% deri 3% nuk është ndarë asnjëherë për implementimin e Strategjisë për Hulumtim. Për më shumë, edhe pse në Strategji për Hulumtim parashihen veprime dhe masa që mund të ndërmerren pa kosto financiare, nuk ka një raport vlerësimi se cilat prej këtyre masave janë ndërmarrë dhe se si planifikohet tutje zbatimi i këtij dokumenti. Po ashtu, Strategjia për Hulumtim parasheh miratimin e një rregulloreje për stimulimin e personelit të përfshirë në punë kërkimore, e cila rregullore deri më tani nuk duket askund në horizont. Për më keq, Grupi Bërthamë⁶, një mekanizëm ky i krijuar me Strategji për Hulumtim për të ofruar mbështetje teknike për planifikimin e së paku 5 projekte kërkimore në vit në UP, thuajse është tërësisht jofunksional.

Në pjesën e mëposhtme do të diskutohen problematikat me të cilat ballafaqohet UP në lidhje me kërkimet shkencore, përkrahjen institucionale dhe funksionimin e instituteve kërkimore shkencore në UP.

Çështjet e ngritura në tryezën e rumbullakët „Strategjia dhe ndikimi i saj në punën e instituteve kërkimore të UP-së”, qershor 2014

Tryeza „Strategjia për Veprimtari Kërkimore-Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013-2016 dhe ndikimi i saj në punën e instituteve kërkimore të UP-së”, e mbajtur më 27 qershor 2014, mbledhi gjithsej 14 përfaqësues të menaxhmentit aktual të UP-së, profesorë universitarë dhe përfaqësues të organizatave think-tank, për të diskutuar gjendjen e kërkimeve në shkencat shoqërore në UP. Dokumentet referenciale për organizimin e tryezës ishin rekomandimet e dalura nga katër analizat paraprake të botuara në kuadër të Dialogut për Politika të RRPP koordinuar nga CPC. Strategjia për Hulumtim ofron veprimet dhe masat konkrete që duhet të ndërmerren për të avancuar kërkimin shkencor në UP.

⁵ Edhe pse është kërkuar, nuk është arritur të merren të dhënat lidhur me shpenzimet e buxhetit për vitin 2013 me justifikimin se „nuk janë regjistruar të dhënat”.

⁶ Shih <http://www.uni-pr.edu/Kerkime-Shkencore/Grupi-Berthame.aspx> (qasur më 5 korrik 2014).

Profesori Arben Hajrullahu nga Departamenti i Shkencës Politike hapi diskutimin duke theksuar rëndësinë e mbështetjes së kërkimeve shkencore në përgjithësi dhe hulumtuesve të rinj në veçanti. Ai iu referua rolit që duhet të luajnë institutet kërkimore në kuadër të UP-së dhe sfidave me të cilat ballafaqohen ato tani.⁷ Pjesa më e madhe e këtyre instituteve nuk gëzojnë përkrahje financiare nga UP-ja dhe kanë ngelur të jenë relativisht jo-funksionale.

Znj. Hasnije Ilazi, Prorektore për Bashkëpunim Ndërkombëtar, profesoreshë në Departamentin e Filozofisë dhe Drejtoreshë Ekzekutive e Institutit për Studime Sociale dhe Humanistike, u fokusua në një aspekt specifik të strategjisë, respektivisht fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar. Sipas saj, „Bashkëpunimi ndërkombëtar është parakusht për të krahasuar UP-në me botën dhe për t'i ikur vetëkënaqësisë”. Në këtë kontekst, ajo përmendi raportin e vlerësimit të ekspertëve ndërkombëtarë të cilët e kanë vlerësuar UP-në dhe akredituar atë për pesë vitet e ardhshme. Një numër problemesh u identifikuan, e të cilat përbëjnë shtyllën e problemeve. Znj. Ilazi theksoi se Instituti të cilin ajo e udhëheq pranë Fakultetit Filozofik, nuk ka marrë asnjëherë ftesë për të kontribuar në hartimin e këtij dokumenti. Meqenëse znj. Ilazi i referohet drejtpërdrejt raportit të vlerësimit të ekspertëve ndërkombëtarë për akreditimin e UP-së, atëherë në vijim paraqesim atë se si këta të fundit vlerësojnë lidhur me Strategjinë për Hulumtim:

„Universiteti ka zhvilluar Strategjinë për Veprimtari Kërkimore-Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013-2016, që paraqet një fillim të mbarë. Sidoqoftë, duhet pasur kujdes me planifikimin super ambicioz dhe me planifikimin joreal financiar të cilat mund të pengojnë apo shkaktojnë shkurtimin e një numri të aktiviteteve të planifikuara. Ky duket të jetë problem i kësaj strategjie. Problem tjetër është se si kjo Strategji është zhvilluar...[Ekspertët] kanë përshtypjen se Strategjia është zhvilluar brenda një rrethi të kufizuar dhe nuk është shpërndarë gjerësisht në mesin e komunitetit”.⁸

Në seksionin e titulluar „Kërkimi”, raporti vlerësues për UP-në vëren se kërkimi ende nuk është prioritet i lartë në UP. Raporti jep vërejtje për mungesën e përfshirjes së studentëve të doktoratës në kërkime shkencore dhe rekomandon se UP-ja duhet të ndërtojë një platformë komunikimi dhe të përfshijë industrinë në kërkimet që bëhen në universitet. Po ashtu, në raport rekomandohet që „stafi akademik duhet të mbështetet dhe motivohet, dhe niveli i aktivitetit kërkimor duhet të njihet qartësisht përmes procedurave të promovimit të stafit”.⁹

Pos këtyre, znj. Ilazi, theksoi dy çështje të tjera përtej rekomandimeve të propozuara nga raporti vlerësues për akreditimin e UP-së. E para është **ndërkombëtarizimi i kërkimit**, ku kërkimet në Kosovë do të duhej të reflektonin edhe trendet dhe temat kërkimore në rajon dhe

⁷ Aktualisht janë pesë institute dhe një qendër përsosmërie në mësimdhënie. Këto janë: Instituti për Studime Sociale dhe Humanistike; Instituti për Ekzaminim të Materialeve; Instituti i Medias; Instituti për Hulumtime Ligjore, Instituti për Miniera, Metalurgji, Gjeologji dhe Teknologji, dhe Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie.

⁸ Evaluation Review Report of University of Prishtina „Hasan Prishtina”. Agjencia e Akreditimit të Kosovës: Prishtinë, maj 2014, f. 15. Anëtarët e ekipit të angazhuar për draftimin e raportit janë: Dr. Norman Ryan, Universiteti College Cork, Irlandë (kryesues); Prof. Dr. Melita Kovacevic, Universiti i Zagrebit, Kroaci; Ms. Emilia Todorova, Universiteti i Glasgou, Mbretëria e Bashkuar.

⁹ Po aty, f. 16.

në botë. E dyta është nevoja e menjëhershme për të pajisur institutet kërkimore me më shumë burime dhe për të ofruar autonomi më të madhe për të menaxhuar me buxhetet e tyre. Procedurat burokratike paraqesin vështirësi për institutet kërkimore në mënyrë që të jenë funksionale dhe eficiente.

Në fjalën e tij Rektori (u.d.) Anton K. Berishaj, profesor në Departamentin e Sociologjisë, theksoi se, problemi nuk qëndron vetëm te mungesa e fondeve për kërkime shkencore, por edhe tek qasja e stafit akademik ndaj mjeteve të ndara për kërkime shkencore. Z. Berishaj theksoi se në të kaluarën edhe pse janë ndarë disa fonde për kërkime shkencore, ato kanë mbetur pa u shfrytëzuar. Andaj, sipas z. Berishaj, kjo nuk ka rezultuar si pasojë e mungesës së interesimit, por për shkak të procedurave që dekurajonin hulumtuesit për të aplikuar për këto fonde.

Z. Muhamet Mala, Prorektor për Kërkime Shkencore, profesor në Departamentin e Historisë, përmendi një praktikë pozitive në kuadër të UP-së. Kjo praktikë ka të bëjë konkretisht me krijimin e bordit industrial në kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike, e i cili bord këshilldhënës profesional ka bashkëpunim me ndërmarrje publike, si p.sh Korporata Energjetike e Kosovës. Vërejtja e ndërmarrjeve publike dhe industrive të tjera që janë të lidhura me UP-në ka qenë se UP nuk ka një modul për përgatitje menaxheriale dhe komunikuese, shkathtësi këto të cilat tek shkencat teknike mungojnë bukur shumë. Z. Mala sugjeroi UP-në që të ofrojë kurse të cilat përveç përgatitjes profesionale studentët i aftësojnë edhe me shkathtësi menaxheriale dhe të komunikimit. Në këtë mënyrë, theksoi z. Mala, mundësia e lidhjes së programeve studimore të UP-së me tregun e punës do të rritej.

Znj. Merita Berisha, Prorektore për Zhvillim dhe Cilësi, profesoreshë në Fakultetin e Mjekësisë, theksoi se duhet të ngriten kapacitetet avokuese të UP-së rreth ndarjes së mjeteve për kërkime. Po ashtu, pikë tjetër me rëndësi për znj. Berisha ishte fuqizimi i mobilitetit të stafit jo vetëm të jashtëm në raport me partnerët e UP-së, por edhe të mobilitetit brenda njësive akademike në mënyrën e shfrytëzimit të pajisjeve dhe laboratorëve. Znj. Berisha theksoi se në kuadër të studimeve të doktoratës do të ishte mirë që të fuqizohet „mësimi në distancë” dhe të zhvillohen module në gjuhën angleze. Trajnimet për zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe shkencor, për stafin akademik dhe studentët në programe të doktoratës do të ndikonin drejtpërdrejt në ngrijtjen e cilësisë së kërkimit shkencor.

Z. Hysen Bytyqi, anëtar i Grupit Bërthamë për ofrimin e asistencës teknike dhe hartimit të projekteve kërkimore të UP-së, profesor në Fakultetin e Bujqësisë, diskutoi për rolin e Grupit Bërthamë dhe procesin se si ishte hartuar Strategjia për Hulumtim. Roli i Grupit Bërthamë, i cili parashihet edhe në Strategji për Hulumtim, është ofrimi i asistencës teknike dhe shkencore për projektet e universitetit. Lidhur me masat që janë paraparë në Strategji për Hulumtim, z. Bytyqi tha se disa masa tashmë janë implementuar. Pesë programet e parapara të doktoratës dhe një program ndërdisiplinar janë arritur. Sipas z. Bytyqi, UP-ja ka tashmë dy programe interdisiplinare në fushën e mjekësisë dhe në shkencat natyrore. Ajo që ka ngelur e parealizuar, sipas z. Bytyqi, është krijimi i bursave për mobilitete dhe qëndrime afatshkurtëra hulumtuese jashtë vendit. Z. Bytyqi riktheqsoi edhe njëherë se UP do të duhet të rregulloj bazën ligjore për të stimuluar stafin akademik që është i përfshirë në projekte hulumtuese.

Ideja kryesore për krijimin e një rregullore për stimulim të stafit hulumtues ka të bëjë edhe me faktin se ata pak shkencëtarë që kanë arritur të përfshihen në projekte ndërkombëtare ose që kanë fituar projekte, në vend që të përkrahen janë shikuar me sy dyshues, si „oportunistë”, ose „keqpërdorues të fondeve të huaja”.

Rekomandime për Universitetin e Prishtinës:

Të përgjithshme:

- Të inicohet rishikimi në plotëni i Strategjisë për Huluntim dhe të përfshihet komuniteti i shkencëtarëve, hulumtuesve dhe partnerëve të tjerë të interesuar në këtë proces bazuar në qasjen nga „poshtë-lart”;
- Të planifikohet në parametra real, konkret dhe të zbatueshëm buxheti dhe alokimi i tij, për zbatimin e Strategjisë për Huluntim;
- Të fillohet puna për hartimin e Strategjisë për Veprimtari Kërkimore-Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2017-2020 bazuar në përvojat dhe mësimet nga Strategjia aktuale;
- Të marrë parasysh praktikat dhe mësimet e marrura nga shtetet tjera, mundësisht edhe ato nga rajoni.

Specifike:

Ngritja e etikës dhe kualitetit të hulumtimit

- Të ndiqet një politikë e vendosur anti-plagjiazëm;
- Të funksionalizohet dhe të mbështetet plotësisht Komisioni i Etikës, i cili duhet të punojë në mënyrë të pavarur, pa ndikime politike, dhe të jetë filtri i çdo gradimi akademik, përfshirë marrjen dhe anulimin e thirrjeve akademike të fituara bazuar në mashtrime;
- Të themelohet një grup i ekspertëve të jashtëm të përzgjedhur në mënyrë transparente, me referenca adekuate, të cilët do të hartonin raporte gjashtëmujore mbi implementimin e masave të përcaktuara nga Strategjia për Huluntim;
- Të krijohen marrëdhënie kontraktuale me stafin duke obliguar stafin akademik që 30% nga totali i normës së orëve të dedikohen në punë kërkimore.

Reforma të brendshme të politikave dhe praktikave

- Të thjeshtëzohen dhe profesionalizohen të gjitha procedurat dhe kohëzgjatjet për shfrytëzimin e fondeve ekzistuese për kërkime dhe publikime shkencore;
- Të rifunksionalizohen dhe riorganizohen institutet kërkimore aktuale duke planifikuar buxhetin vjetor për veprimtarinë e këtyre instituteve dhe të themelohen institute të tjera të nevojshme;
- Të miratohet një rregullore për stimulimin financiar të personelit akademik të përfshirë në punë kërkimore;
- Të themelohet „Çmimi për punimin më të mirë të vitit” në disiplina të ndryshme apo ndërdisiplinare, të botuar qoftë nga stafi apo nga studentët në revista me kredenciale dhe recension ndërkombëtar;

- Të riorganizohet, të ndahet një buxhet specifik dhe të krijohen kapacitetet e Grupit Bërthamë, mekanizëm ky i krijuar me Strategji për Hulumtim, për planifikimin dhe ofrimin e asistencës teknike për projektet kërkimore në UP;
- Të aprovet Kodi Etik për hulumtime në terren, që precizon mënyrën e marrjes së informatave dhe procedimin e tyre në pajtim me etikën e hulumtimit, si kriter bazik, metodologjik i kërkimeve shkencore dhe në përputhje me vlerat humane.

Krijimi i bashkëpunimeve të jashtme

- Të zbatohen marrëveshjet e nënshkuara me universitete të tjera partnere dhe të ndërtohen partneritete të reja funksionale e strategjike ndërkombëtare;
- Të themelohet një zyrë administrative, ku do të kontraktoshin ekspertë të huaj dhe vendorë për shkrimin e propozimeve për projekte, gjetjen e partnerëve ndërkombëtarë dhe aplikimin në fondet e Bashkimit Evropian, si „Horizon 2020”;
- Të kërkohet nga të gjitha njësitë akademike të themelojnë borde këshilldhënëse që do të përfshinin kompani publike, komunitetin e biznesit, media, shoqëri civile dhe organizata think- tank. Përfshirja e të gjitha palëve të interesuara në procesin e hartimit të programit të kurrikulës dhe të lëndëve akademike në një njësitë përkatëse akademike, do të rezultojë me ngritje të vetëdijes mbi përmbushjen e kërkesave të tregut për fuqinë deficitare punëtore;
- Të bashkëpunohet me ndërmarrjet publike, bizneset private, MASHT-in dhe partnerët ndërkombëtarë dhe të krijohet një fond i veçantë mobiliteti për kuadro për qëndrime hulumtuese jashtë vendit si dhe të ftohen hulumtues dhe profesorë mysafirë;
- Të bashkëpunohet me institucionet publike, komunitetin e biznesit, organizatat think-tank dhe të obligohen studentët të realizojnë praktika pune dhe punë kërkimore shkencore. Praktika do t'u mundësonte studentëve të zhvillojnë tutje shkathtësitë e tyre për të realizuar punë kërkimore shkencore.

Programi për Promovim të Hulumtimeve Rajonale (RRPP) udhëhiqet nga Universiteti i Friburgut me përkrahjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim (SDC), Departamentit Federal për Punë të Jashtme.

Pikëpamjet e shprehura në këtë analizë janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e SDC apo të Universitetit të Friburgut.